

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 28 PRILL 2022

Të nderuar bashkëqytetarë,

Të nderuar kolegë,

Kryeministri tha sot se i kemi arritur ato që kemi thënë. Në fakt, në këta 9 vjet ka arritur të dyfishojë numrin e të papunëve; ka arritur të dyfishojë numrin e personave që kanë bërë eksod, ka arritur të dyfishojë çmimin e naftës; ka arritur të dyfishojë çmimin e energjisë elektrike, ka arritur të dyfishojë çmimin e ushqimeve të shportës, madje ka arritur të dyfishojë edhe tarifat dytësore të Postës Shqiptare. Pra, shqiptarët sot janë shumë më të varfër se dje, për shkak të asaj çfarë premtion dhe bën ky Kryeministër. Enti Rregullator i Energjisë Elektrike ka tagër kryesor vendosjen e çmimit, dhe vendosja e çmimit është kostoja e saj.

Në fakt, Enti Rregullator nuk ka luajtur rolin për të cilin paguhet, por ka qenë thjesht një sekretari e qeverisë. Çmimi nuk është vendosur mbi bazën e kostos, por sipas tekave të qeverisë. Në fakt, qeveria e ka tagrin për të ndërhyrë, por ajo ndërhyt vetëm atëherë kur subvencionon çmimin e fashave të ndryshme. Nuk arritëm të shikonim në raport se cili ishte borxhi i OSHEE-së apo i institucioneve të tjera. Ne nuk e dimë se sa është sasia dhe sa është numri i huave të marra, por di të them që pothuajse në dy seanca aprovojmë marrjen e një borxhi. Aq shumë borxhe kemi marrë, sa që fluksi i eurove të marra nga OSHEE-ja ka bërë të mundur që për herë të parë në 20 vjet euro të bjerë poshtë nivelit 120 lekë. Është vërtet e dhimbshme, sepse kjo ulje ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë tek eksportuesit, te fasoneritë e të tjera, që marrin më pak para dhe për pasojë do të ketë më pak të punësuar në këta sektorë.

Përveç borxhit kemi edhe rritjen e çmimit. Vetëm për bizneset dhe jo pak, por për 7500 biznese, që nga 1 janari e deri sot çmimi është rritur nga 110 lekë në 196 lekë, madje edhe aprovimi për këtë është bërë në muajin prill të këtij viti. Dyfishimi i punonjësve apo i pagave në sektorin e energjisë elektrike në këta 9 vjet ka qenë një tjetër gangrenë. Është rritur numri i të punësuarve si në asnjë vend tjetër. Në fakt, Shqipëria thyen rekordin, ku 26,5% e të punësuarve janë punonjës publik. Rekordin e këtij numri e ka OSHEE-ja. A nuk do të ishte normale që ky fond të shkonte për kompensimin e familjeve, të cilat sot nuk

kanë energji elektrike? Nuk u përmend në raport, por sot ka me mijëra familje në Shqipëri që nuk kanë energji elektrike, sepse nuk kanë mundësi për ta paguar.

A nuk do të ishte e udhës që kjo pjesë e fondit të pagave, që është dyfishuar, të shkojë për të subvencionuar këto familje, që sot nuk kanë energji elektrike? Bursa duhet të funksiononte që në vitin 2015, por, në fakt, pavarësisht se e ka pasur bazën ligjore për të filluar, u shty për vitin 2021, pastaj për vitin 2022 dhe tani, pavarësisht se thuhet që do të jetë funksionale në vitin 2022, kanë filluar të thonë se do të jetë në vitin 2023. Monopolizimi Janë jo pak, por 50 deri në 300 HEC-e të vogla, të cilat nuk kanë marrë akoma lejen për të filluar. Nuk kemi asnjë energji që prodhohet, pra energji diellore. Madje, të paktën nga kontaktet që kam pasur me bizneset, nuk shfrytëzohet energjia që ato marrin. Çfarë do të thotë kjo? Bëhet rakordim mujor, nuk bëhet rakordim 1- vjeçar. Kjo do të thotë që dikush që prodhon në gusht me një kapacitet dy herë më shumë se nevojat, duhet t'ia japë falas OSHEE-së dhe kjo ka sjellë si pasojë ndrydhjen e kësaj situate.

Për shitblerjen e energjisë elektrike ka një dualizëm ndërmjet OSHEE-së, KESH-it dhe TPL-së se kush do të jetë blerësi. Në fakt, ka ndodhur që energjia elektrike të shitet me çmimin 65 euro dhe të blihet me 219 euro, të shitet me 150 euro dhe të blihet me 390 euro, çka do të thotë se është shoqëruar me një humbje të energjisë elektrike. Humbjet në rrjet sot janë 22%, pavarësisht se janë investuar me miliona euro, një shifër rekord, e pakrahasueshme dhe vërtet skandaloze. Borxhi i enteve buxhetore dhe jobuxhetore vazhdon të jetë një gangrenë. Qeveria duhet të ndërmarrë masa jo ndaj qytetarëve, të cilët nuk kanë kapacitete për të paguar energjinë elektrike, por ndaj enteve buxhetore, të cilat janë debitorët më të këqija të OSHEE-së. Faleminderit!